

Data: 08/10/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM VENDOSJE KALDAJE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42310000-2- Kaldaj me djegie; 45331110-0-Instalime Kaldajash

VLERA E FONDIT LIMIT: 28.000.000 lek pa tvsh (njëzet e tetë milion) lekë PA TVSH ose 289.465 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 09/10/2025 është 96,73 Lekë/ Euro.**

Argumentimin e Fondit Limit:

1. Për çmimet për njësi janë marrë në konsideratë:

Në zbatim të Rregullave të prokurimit Publik dhe siç është cituar edhe në urdhërin për ngritjen e Grupit të Punës, janë përdoruar:

- Çmimet e manualit nr.2 dhe 4 të analizave teknike për punimet e ndërtimit viti 2015,
- Testimin e tregut duke marrë oferta nga tre operatorë ekonomikë dhe përlllogaritur çmimin mesatar për njësi, për disa zëra që nuk ishin në manuale si edhe referuar çmimit të kontratave të ngjashme të mëparëshme.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor, brenda 3 (tre) muajve.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë, pasi do e bënte shumë të vështirë për t’u menaxhuar.

Kjo procedurë malli duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues pas procesit të minikonkursit, pasi furnizimi i artikujve nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e furnizimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të furnizimit me materiale kancelarie për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve të

administratës për përdoruesit, si dhe kosto shtesë për AK.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e artikujve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësohte realizimin në kohë, për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve të administratës për përdoruesit, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale”.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me

kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar, për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në këto kushte, duke qenë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Në varësi të zërave që do të marrin përsipër të mbulojnë apo bashkimin e fuqisë punëtore dhe stafit, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike në rolin e organit blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

a) NS-12A (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku shprehimisht citohet: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë licencat, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe pika 8 e nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.1.3 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) “ose ekuivalent; (të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

➤ SSH/EN/ ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

AK vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 45001:2018 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001:2018 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

➤ SSH/EN/ ISO 27001-2013 mbi “Sistemin e menaxhimit të informacionit” ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të **Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, i ndryshuar, dhe pikën 1 të nenit 44 të **VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, ku përcaktohet se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga organizma kombëtarë ose ndërkombëtarë, nëse ato lidhen ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Ky kriter shërben për të verifikuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë ofertues për furnizimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

- **ISO 27001:2013 ose ekuivalent** siguron një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, duke garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave.

Ky standardizim lejon autoritetin kontraktor të sigurojë ofrues të shërbimeve IT të sigurt, të besueshme dhe me kapacitet të provuar teknik dhe profesional.

➤ SSH/EN/ ISO 20000-1:2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit” ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të **Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, i ndryshuar, dhe pikën 1 të nenit 44 të **VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, ku përcaktohet se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga organizma kombëtarë ose ndërkombëtarë, nëse ato lidhen ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Ky kriter shërben për të verifikuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë ofertues për furnizimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

- **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent** siguron që shërbimet IT të planifikohen, dorëzohen dhe monitorohen sipas standardeve ndërkombëtare të ITSM, duke garantuar cilësi, performancë dhe përputhshmëri me praktikat profesionale.

Ky standardizim lejon autoritetin kontraktor të sigurojë ofrues të shërbimeve IT të sigurt, të besueshme dhe me kapacitet të provuar teknik dhe profesional.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik për këtë objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **tre muajt e fundit**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Licencë për Drejtues Teknik
- Diplomë
- Kontratë pune e vlefshme

Në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

